



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut") nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), nenet 65-ç, paragrafi (3) dhe (65-d), paragrafi (1) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), nenin 16, paragrafi (1), pika 6) dhe nenin 17, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit të Stabilitetit Financiar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 173/22) dhe pikat 11) dhe 14) të Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozime në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/21 dhe 149/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për lartësinë e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndaj vendeve tjera në tremujorin e parë të vitit 2025

1. Përcaktohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lartësi prej 1,5%.
2. Përcaktohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve ndaj vendeve tjera në lartësi të normave që janë të përcaktuara nga organet kompetente të vendeve tjera që janë të publikuara në ueb faqen e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Bankat janë të detyruara ta zbatojnë këtë vendim dhe t'i përfshijnë normat nga pikat 1) dhe 2) i këtij vendimi në përlogaritjet për përcaktimin e normës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për tremujorin e parë të vitit 2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-41700/2
21 dhjetor 2023
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска